



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 133

Prishtinë, më 17.12.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina.

Mungoi : Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj, Boban Todorović, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.12.2013,
3. Debati rreth buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Mjedisit për vitin vijues,
4. Shqyrtimi i ankesës së banorëve të Rugovës rreth Ligjit për Parkun nacional “Bjeshkët e Nemuna”.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe me një plotësim rreth konfirmimit për leximin e dytë të projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.12.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 10.12.2013.

3. Debat i rreth buxhetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Mjedisit për vitin vijues

Kryetari i Komisionit Nait Hasani falënderoi Shefki Kastratin nga NDI për dërgimin e analizës së bërë nga GIZ rreth buxhetit të Ministrisë së bujqësisë (por jo edhe për Ministrinë e mjedisit), mirëpo konstatoi se buxheti i paraparë për vitin 2014 për këtë ministri nuk është në përputhje me kërkesat e parashtruara në raportin e progresit. **Shefki Kastrati** u ndërlihdh me konstatimin se tani komisioni nuk mund të ndryshoi asgjë sa i përket rekomandimeve eventuale, ngase komisioni për buxhet ka përfunduar mbledhjen sa i përket çështjes së vërejtjeve konkrete, ngase ndodhë që buxheti shqyrtohet këtë të enjte në mbledhjen plenare, mirëpo ai shtoi se komisionet funksionale kanë pasur shumë pak kohë ngase ka qenë fushata zgjedhore si dhe projektligji ka arritur në Kuvend dhe ka qenë kohë e shkurtë për të bërë vërejtjet eventuale nga komisionet funksionale. **Salih Morina, Sevdije Lama dhe Afërdita Berisha** ishin të mendimit që pas miratimit të buxhetit të ftohen dy ministrat e ministrive të fushës së komisionit rreth prioritetëve financiarë dhe projekteve në të dy ministritë, me çka u pajtua Komisioni.

4. Shqyrtimi i ankesës së banorëve të Rugovës

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit duke sqaruar kërkesën e parashtruar në Kryesinë e Kuvendit rreth kthimit të Ligjit për Bjeshkët e Nemuna si park nacional në rishikim, edhe pse e njëjta kërkesë ka pasur mangësi formale për shkak se nuk janë 10.000 nënshkrime etj, megjithatë Komisioni ka shprehur gatishmërinë për shqyrtimin e kërkesave të banorëve të kësaj ane. Ndërhyri **Ali Lajçi** (përfaqësues i ankuesve) dhe shtoi se janë të gatshëm ankuesit të ndalin procedurën nëse nuk plotësohen kushtet formale, mirëpo kryetari rikonfirmoi se komisioni shqyrton të gjitha kërkesat që arrijnë nga kryesia e kuvendit duke rikujtuar veprimet e ndërmarra nga komisioni me rastin e shqyrtimit të projektligjit siç janë debatet nëpër komuna etj poashtu njoftoi edhe për procedurën ankimore të këtyre përfaqësuesve të sotëm në Gjykatën Kushtetuese dhe para Avokatit të popullit të cilat institucione vetëm se kanë vërtetuar punën e bërë në këtë komision ku janë duke u zbatuar synimet e këtij shteti për të punuar për qëllimet e përbashkëta rreth hyrjes në BE.

Ali Lajçi shprehu përgëzimet personale për shqyrtimin e kërkesës së parashtruar për këtë rajon siç tha ai të banuar me popullatë në 14 zona kadastrale të cilët vazhdimisht kanë shprehur pakënaqësinë me këtë ligj duke pasur edhe protesta. Arsyeja e kundërshtimit sipas tij është tjetërsimi i pronës dhe mosgaranca se nuk do të ndodhë kjo. Ky ligj do të jetë më funksional nëse hiqen këto 14 zona kadastrale, ndaj sugjeroi që mbledhja plenare të vendosë për këtë çështje ngase kemi të bëjmë 80% të pronës private. Ai theksoi se në fund do të shihet jofunksionaliteti i këtij Ligji, ndaj sugjeroi që më mirë është më herët të shpallet si e tillë.

Arijanit Demaj shtoi se kthimi për herë të tretë dhe miratimi për të katërtën herë i këtij ligji është për të dyshuar ngase prej 62.000 ha 30.000 janë pronë private, ai gjithashtu ju drejtua kryetarit që nuk i ka mbajtur premtimet me rastin e shqyrtimit të këtij projektligji ngase nuk është marr parasysh pëlqimi i 80% të banorëve të asaj ane, kërkesa e ankuesve, vazhdoi, është që zona e banuar të hiqet nga ky ligj. Lidhur me nënshkrime tha se ato mund të sigurohen shumë shpejt, madje më tepër se 10.000 sosh, përndryshe si tha ai “ne Rugovasi, gjithmonë kemi respektuar ligjin”. Ai shtoi se Gazmend Muhaxheri në Pejë ka fitua për shkak se ka thënë që do ta kthejë këtë ligj.

Sali Lajçi gjithashtu insistoi se të njëjtit nuk kundërshtojnë që kjo zonë të jetë e interesit apo turistike, mirëpo assesi park nacional, sepse çdo fshat i Rugovës këtë e kundërshton kategorikisht. Prerjet ilegale të pyjeve, vazhdoi, janë bërë nga APK dhe personat që janë interesuar për prerje, andaj duke parë këtë gjendje popullata ka konstatuar “nëse shteti vjedhë, pse një banorë mos me pas drejtën për 10 kubik dru”. Apeloj për gjakftohtësi dhe shqyrtim të sërishëm të këtij ligji, ndërsa çështjen e demarkacionit e ndau si çështje në vete.

Nait Hasani gjithashtu i konstatoi disa fakte të pamohueshme rreth punës së komisionit në teren, ndërsa tha “pse banorët nuk janë ftuar nga ju (përfaqësues), atë ju e dini”. Me këtë ligj nuk cenohet drejta e Rugovasve por kontrabanda cenohet. **Ali Lajçi** potencoi faktin se asnjëherë nuk janë marr parasysh cilat kompetenca të komunës i merr parasysh parku nacional përkatësisht si mundet të ketë qasje komuna në parkun nacional.

Xhevat Azemi nga agjencia e pronës potencoi faktin se kjo agjenci nuk ka të bëjë me parqet nacionale, mirëpo nga përvoja e tij potencoi faktin se në Kosovë në përgjithësi është pikë e dobët zbatimi i ligjeve, sidomos ato për pronën. Çdo gjë, vazhdoi, që ka vlerë kombëtare krijon kufizime për pronarët (i përmendi disa ligje : për tokën bujqësore etj), ndaj Ligji për parkun nacional duhet të begatohet edhe me buxhet të duhur, ngase duhet të kompensohen pronat private që kufizohen siç janë zonat strikte. Aq sa kuptova unë, vazhdoi ai, këtu bëhet fjalë : a është dashur të bëhet ky ligj. Së pari, Kosova nuk ka ligj për denacionalizim dhe nuk ka iniciativa që nga koha e UNMIK-ut i cili sugjeronte “derisa nuk jeni shtet, nuk mund të keni këtë ligj” ngase privatizimi nuk bëhet pa denacionalizim. Përfundimisht ai konstatoi se ky ligj nuk ndikon në prona private ngase ato nuk transformohen me këtë ligj, prandaj kjo është më tepër çështje politike sipas tij.

Ilir Morina kryeshef i agjencisë së mjedisit insistoi në bashkëpunim si çështje jetike ngase vetëm me bashkëpunim është arit ky kompromis : Ligji me 6 nene për parkun nacional “Bjeshkët e Nemuna”, përndryshe parqet i rregullon Ligji për mbrojtjen e natyrës. Parku në fjalë përfshin vetëm 10% zonë strikte të sipërfaqes prej 62.000 ha dhe është larg prej zonës së banuar (ku ariu nuk ka mundësi me ik nga njeriu). Drejtoria e parkut në Pejë është themeluar me kërkesën e banorëve të atyshëm dhe gjithsesi është insistuar që punëtorët e APK të kalojnë në këtë drejtori në bazë të memorandumit, ndërsa puna e mëtejme dhe kryesore është përqendruar tek hartimi i planit hapësinor të zonimit të parkut nga secili komunë veq e veq bashkërisht me ekspertët përkatës, shtëpizat apo stanet do të janë në zonën e 3. Ai gjithashtu i siguroi të pranishmit që MMPH ka bërë edhe filmim dokumentar për punën profesionale të bërë rreth planit dhe zonimit bashkë me UNDP për të qenë sa më transparent, gjithashtu ministria është angazhua të dyfishoi kubikazhën për furnizim me dru të secilit banorë, gjithnjë në bashkëpunim me përfaqësuesin e komunës së Pejës. Ky plan, shtoi ai, do të hartohet në bazë të dëgjimeve publike që do të organizohen dhe do të kanë mundësi të ankohen gjithë të pakënaqurit, gjithashtu secili pronar privat do të ketë drejtën me shit pronën e vet përmes drejtorisë (kërkesa me shkrim për shitje është e standardizuar), dhe çka është më kryesore investimet janë duke ardhur me çka mund lirisht të konkludoi si tha ai “secili do të lus të jetë pjesë e parkut nacional për shkak të beneficioneve që ofron”.

Afërdita Berisha sqaroi ankuesve se ajo në cilësinë e deputetes gjithmonë është e përkushtuar të mbrohet prona private, me këtë edhe vlerat tjera kombëtare për një shtet, ndaj mbetet që sa më tepër të komunikohet me të painformuarit. Ligji i parkut nacional duhet të mbrojë natyrën dhe biodiversitetin, assesi të ketë ingerenca tek prona private, përfundoi ajo. Xhevat Azemi përsëriti qëndrimet e lartcekura dhe theksoi se ligji i legalizimeve ka përjashtuar parqet në kuadër të tij.

Sevdije Lama potencoi faktin se nuk ka qenë ideja që me këtë ligj të dëmtohet dikush, përkundrazi sepse shihet qartë se pyjet tani janë në gjendje më të mirë se përpara, gjithashtu ajo shtoi se komisioni ka zhvilluar debatet nëpër komuna.

Ramiz Qoraj nga fshat Drelaj pyeti a nuk paska mënyrë tjetër përveç kësaj, për të shpëtuar vlerat kombëtare duke dëmtuar pronën private, ndaj kategorikisht kërkoi kthimin e ligjit dhe mos të emërtohet si park nacional.

Agim Nikqi përsëriti disa fakte të cekura më lartë duke potencuar se ky ligj është kundër banorëve të parkut.

Salih Morina tha se i dëgjoi me vëmendje vërejtjet e ankuesve të cilat në fakt janë pjesë përbërëse të procedurave ligjore, ngase një ligj që nuk zbatohet normalisht që kërkon ndryshimin apo përshtatjen me realitetin, sipas tij duhet të shkojmë gradualisht dhe të shohim tani çka mund të realizohet me Ligjin për planifikim hapësinorë ngase ky ligj nuk përfundon me kaq, përkundrazi ky është fillimi ku do të mblidhen faktet e nevojshme bashkë me popullatën për të parë se a ka zbatim apo jo.

Ali Lajçi përfundoi me konstatimin se kjo mbledhje nuk dha përgjigjen e kërkuar nga parashtuesit të ankesës, ngase prona private në asnjë mënyrë nuk garantohet me këtë Ligj i cili patjetër duhet të harmonizohet me ligjet tjera.

Nait Hasani megjithatë falënderoi në bashkëbisedim dhe shtoi se Komisioni do të vazhdoi me trajtimin e çdo ankese që do të arin në këtë komision si dhe do të rekomandoi për procedurat e mëtejme për çdo çështje të iniciuar, mirëpo për këtë rast të këtyre ankuesve ky Komision asgjë nuk mund të rekomandoi për shkak se nuk janë plotësuar kushtet formale që kërkohen sipas Rregullores së Kuvendit.

5. Të ndryshme

Nait Hasani në pikën të ndryshme njoftoi se **Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje** ka përfunduar me shqyrtim në komisionet e përhershme, ndaj konstatoi konfirmimin e komisionit për leximin e dytë por edhe **kërkesën e komisionit** për të shqyrtuar mbledhja plenare më 19.12.2013 këtë projektligj si pikë të veçantë, për shkak të rëndësisë që ka ky ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani